

...vijon nga numri i kaluar

GJON BORICI

Instituti i Historisë/Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë
gjon.borici@asa.edu.al

KREDITË SOVJETIKE AKORDUAR SHQIPËRISË NË PERIUDHËN 1945-1960

(Pjesa e dytë)

Abstrakt:

Pjesa e dytë e artikullit "Kreditë sovjetike akorduar Shqipërisë në periudhën 1945-1960", përqendrohet më së shumti te pasojat që pati në politikën ekonomike dhe të jashtme të shtetit shqiptar në vitin 1960. Në këtë hark kohor të shkurtër, politika e Enver Hoxhës dhe e klikës së tij, duke ndier presionin e madh ekonomik në të cilin e kishte vendosur udhëheqja sovjetike veçanërisht në gjysmën e parë të vitit 1960, detyroi liderin komunist shqiptar të shihte me përparësi absolute marrëdhëniet e vështira që po kalonin dy shtetet gjigante të komunizmit botëror: Bashkimi Sovjetik dhe Republika Popullore e Kinës. Do të ishte në fakt kjo përplasje ndërmjet këtyre shteteve për supremaci në Kampin Socialist dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, që do të jetë "varka e shpëtimit" për pushtetin e Enver Hoxhës. Ai pati vërtet fatin e madh t'i mbijetonte presionit ekonomik dhe rrjedhimisht politik të Bashkimit Sovjetik vetëm falë çarjes së fortë në marrëdhëniet sovjeto-kineze. Në këtë pjesë të dytë të artikullit, bazuar në dokumente autentike arkivore shqiptare të cilat kanë qenë të paaksesueshme për një kohë të gjatë, u paraqiten studiuesve dhe jo vetëm, të dhëna të paimagjinueshme dhe u jepen përgjigje shumë dilemave se si shpëtoi pa i hyrë "gjemb në këmbë" Enver Hoxhës nga përplasja që ai pati me liderin sovjetik Nikita Hrushov dhe me të gjithë Kampin Socialist, i cili u rreshtua në krah të Bashkimit Sovjetik në konfrontimin e këtij të fundit me Kinën. Artikulli është historiko-analitik, ku i bëhet një analizë e plotë situatës ekonomike të Shqipërisë dhe jepen arsyet e mbijetesës së saj ekonomike e rrjedhimisht politike në këtë fazë të Luftës së Ftohtë.

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Bashkimi Sovjetik, Kinë, ekonomi, borxhe, detyrime financiare.

**Në vend të hyrjes: "Mëkati" ekonomik
që një vend nuk duhet të bëjë**

Pjesa e dytë e këtij artikulli përpiket që të japë argumentet e duhura se përse regjimi komunist i Enver Hoxhës ia doli mbanë të mbijetonte në një situatë tërësisht të pafavorshme për të. Në fakt, ka arsye se përse shteti dhe regjimi që e mbështet bie apo mbijeton. Në rastin e Shqipërisë e gjithë situata katastrofike ekonomike në të cilën ishte zhytur vendi si pasojë e borxheve të mëdha për të cilat kemi folur në pjesën e parë të këtij artikulli studimor botuar në numrin e kaluar të revistës “Studime Historike”, nuk linte shkak për asnjë mëdyshje se si do të përfundonte regjimi komunist shqiptar nëse do të prishte marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik (më tej: BS). Një nga gabimet më të mëdha të regjimit të drejtuar nga Enver Hoxha ishte pakënaqësia ndaj çdo shume të marrë nga BS dhe vendet e tjera duke bërë atë që në gjuhën ekonomike quhet mëkati "i pamjaftueshmërisë", apo të qenët "i pangopur" nga ajo që i është dhënë.¹ Nga keqinvestimi i këtyre kredive, Shqipëria dilte gjithnjë me humbje të mëdha dhe akoma më i rëndë ishte fakti se akumulimi i borxheve të tilla të papërballueshme sidomos në këtë periudhë, nuk do të sillte përmirësimin e jetesës ekonomike, përkundrazi do ta rëndonte më shumë atë. Gabimin më të madh që bëri udhëheqja komuniste nën drejtimin e Hoxhës ishte se nuk dinte të bënte dallimin në ekonomi mes kapitalizmit dhe socializmit. Në kapitalizëm nuk ka urdhër për të planifikuar, ka standard. Në socializëm është totalisht e kundërta, ka urdhër, jo standard.² Periudha në të cilën jam përqendruar i përket vitit 1960, një vit kyç ky në marrëdhëniet ndërkombëtare kur ndodh çarja e madhe ndërmjet BS dhe Republikës Popullore të Kinës (më tej: RPK) dhe arsyeja se përse Shqipëria u rreshtua pikërisht në krah të vendit të largët aziatik kundër "bamirësit" të madh liderit të Kampit Socialist,

¹ James R. Otteson, *Seven deadly economic sins; Obstacles to prosperity and happiness every citizen should know* (New York: Cambridge University Press, 2021), 63.

² *Po aty*, 114.

arsyet e mbijetesës së saj dhe përse vijoi me kokëfortësi të refuzonte çdo afrim me Perëndimin.

Kërkesa për kredi nga qeveria shqiptare për të ngritur nivelin e jetesës së popullit dhe raporti i Bankës së Shtetit Shqiptar mbi dobësinë ekonomike të Shqipërisë

Më 7 janar 1960, këshilltari tregtar i RPSH-së në Bashkimin Sovjetik, Muhamer Spahiu, i dërgoi njoftim zëvendëskryeministrit Spiro Koleka dhe për dijëni ministrit të Tregtisë Kiço Ngjela mbi letrën e qeverisë sovjetike lidhur me pagesën që duhej t'ua kryente Shqipëria specialistëve sovjetikë që punonin në Shqipëri.³ Nga ana e Republikës Popullore të Shqipërisë (më tej: RPSH) kërkohet respektimi i marrëveshjes së nënshkruar mes dy vendeve në vitin 1949, e cila nuk ndryshonte nga marrëveshja e nënshkruar me vendet e tjera të kampit.⁴ Këshilltari tregtar Spahiu informoi se letra e qeverisë sovjetike linte të kuptohej se pa u respektuar marrëveshja për specialistët sovjetikë që punonin në Shqipëri, do të mbahej pezull çështja për dërgimin e specialistëve shqiptarë për eksperiencë në Bashkimin Sovjetik.⁵ Qeveria sovjetike kërkonte nga qeveria shqiptare që të paguante specialistët sovjetikë që punonin atje, edhe pse ishte e vetëdijshme për vështirësitë ekonomike të vendit.⁶

Nuk ishte thjesht njoftimi i Muhamer Spahiut problemi i vetëm me të cilin do të përballlej Shqipëria në tremujorin e parë të vitit 1960. Më 25 janar, nga Banka Qendrore e Bashkimit Sovjetik saktësisht nga Departamenti i Lidhjeve me Jashtë, Banka e Shtetit Shqiptar u njoftua se duhej të kryente pagesat përfshirë interesat për kreditë e akorduara nga BS në vitet 1957-1959.⁷ Sipas letrës konfidenciale të ardhur nga Moska, interesat e kredive për vitet 1957-1959 ishin 712 151,4 rubla dhe deri më

³ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) 490 / Këshilli i Ministrave (më tej: KM), Viti (më tej: V.) 1960, Dosja (më tej: D.) 1327, fl. 1. Letër e qeverisë sovjetike mbi projekt-marrëveshjen për dërgimin e specialistëve.

⁴ Po aty, fl. 2.

⁵ Po aty.

⁶ Po aty.

⁷ Po aty, F. 506 / Banka e Shtetit Shqiptar (më tej: BSHSH), V. 1960, D. 28, fl. 15. Interesat për vitet 1957-1959, tremujori i parë i vitit 1960.

9 mars Shqipëria duhej të paguante 489 423,15 rubla.⁸ Deri më 20 dhjetor, interesat që duhej të paguante Shqipëria ishin 2 936 533,15 rubla.⁹ Nëse shohim me shumë kujdes këtë dokument, protokollin e 17 prillit 1957, e detyronte Shqipërinë t'i paguante BS-së deri në fund të vitit 1960 edhe 3 096 629 rubla.¹⁰ Vetëm për harkun kohor 1957-1959, deri në vitin 1969 sipas protokollit të 17 prillit 1957, Shqipëria detyrohej t'i paguante çdo vit BS-së 340 025,66 rubla me një shumë totale prej 3 400 277,66 rubla interesa bankare.¹¹

Problem për t'u paguar nuk ishte vetëm BS-ja, por edhe vendet e demokracive të tjera popullore të Kampit Socialist. Më 18 prill 1960, Banka e Shtetit Shqiptar depozitoi në Bankën Shtetërore të Çekosllovakisë një shumë prej 100 000 lekë.¹² Se për çfarë e depozitoi Shqipëria në Pragë shumë e lartpërmendur, dokumenti nuk na e sqaron. Një tjetër problem që kishte vendi gjatë këtij fillimviti 1960, ishin edhe të ardhurat e pakta në valutë të huaj. Vetëm për muajin janar 1960, nga të gjitha rrethet e vendit për t'u depozituar në Bankën e Shtetit, ishin grumbulluar gjithsej 176 895 dollarë amerikanë.¹³ Një shumë e tillë e realizuar për të bërë tregti me jashtë tregonte situatën qesharake ekonomike në të cilën ndodhej vendi dhe, mbi të gjitha, izolimin e palogjikshëm tregtar ku e kishte çuar Enver Hoxha dhe klika e tij Shqipërinë. Një shifër e tillë qesharake për një shtet në dukje të lirë, ishte tragjike për ekonominë e vendit. Vendet e tjera socialiste në Europë si p.sh. Hungaria, qarkullimin tregtar në valutë të huaj e kishin disa milionë deri në dhjetëra milionë dollarë për dekadën 1951-1960.¹⁴ Rezervat në

⁸ *Po aty.*

⁹ *Po aty.*

¹⁰ *Po aty.* "Shlyerjet sipas protokollit të 17 prillit 1957 duke filluar nga 20 mars 1960 deri më 20 dhjetor 1960, gjithsej 3 096 629 rubla. Çdo muaj Shqipëria do të paguante 258 052 rubla. Për protokollin e 23 marsit 1956, Shqipëria do të paguante nga 20 marsi deri më 20 dhjetor 1960, 2 936 533,15 rubla. Çdo muaj 244 711 rubla".

¹¹ *Po aty*, fl. 19.

¹² *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 30, fl. 5. Pagesa në Pragë.

¹³ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 31, fl. 1. Valuta të ardhura gjatë muajit janar 1960.

¹⁴ Csaba Békés and Dániel Vékony, "Unfulfilled promised lands: missed potentials in relations between Hungary and the countries of the Middle East", në *Warsaw Pact Intervention in the Third World; Aid and Influence in the Cold War*, ed. Philip E. Muehlenbeck and Natalia Telepneva (London: Bloomsbury, 2018), 292. "Hungaria për vitin 1960 importonte mallra në vlerën 11.455.000 forinta dhe eksportonte 10.259.000 forinta (1\$=11.74 forinta sipas konvertimit të datës 22.4.1960)".

dollarë amerikanë të mbledhura nga Shqipëria për vitin 1960 ishin 2 047 378.¹⁵

Duke qenë të ndërgjegjshëm për nivelin dëshpërues ekonomik dhe rezervat katastrofike të mbledhura në valutë, Këshilli i Ministrave i RPSH-së me vendim të datës 9 prill 1960, urdhëronte Bankën e Shtetit Shqiptar të merrte masa për krijimin e Fondit të Paprekshëm në valutë të lirë (\$).¹⁶ Duke parë edhe shtrëngesën financiare të filluar nga Bashkimi Sovjetik që Shqipëria të paguante kreditë, Këshilli i Ministrave i RPSH-së, vendosi krijimin e fondit të lartpërmendur për vitet 1960-1965 sipas viteve të mëposhtme:

1. 1960 (900 000 \$);
2. 1961 (1 500 000 \$);
3. 1962 (2 000 000 \$);
4. 1963 (2 500 000 \$);
5. 1964 (3 000 000 \$);
6. 1965 (3 500 000 \$).¹⁷

U vendos që fondet e mësipërme nëse do të duhej të prekeshin, kjo do të bëhej vetëm me urdhër të Byrosë Politike të Komitetit Qendror (më tej: KQ) të Partisë së Punës të Shqipërisë (më tej: PPSH).¹⁸ Ndërhyrja e Byrosë Politike dhe personalisht e Enver Hoxhës deri në detajet e ekonomisë shqiptare, ishte një tjetër karakteristikë negative për vendin. Ishte e dukshme se ekonominë e Shqipërisë nuk e drejtonin ata pak profesionistë që mund të ishin, por një Byro Politike e paaftë dhe totalisht jashtë çdo realiteti ekonomik. Banka e Shtetit Shqiptar, pa dyshim që do ta zbatonte me përpikëri maksimale këtë vendim, madje njoftoi qeverinë se për vitin 1960, kishte bërë gati gjysmën e shumës prej 450 000 \$ si dhe 225 000 \$ deri në fund të vitit.¹⁹ Këto shuma të papërfillshme parash për një shtet, në vend që të investoheshin ashtu siç duhej për të rritur qoftë

¹⁵ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 31, fl. 1-12. Shqipëria mbledhje valutë në dollarë amerikanë, viti 1960: janar 176 895; shkurt 12 342; mars 163 831; prill 161 671; maj 184 304; qershor 139 630; korrik 186 357; gusht 184 144; shtator 185 323; tetor 161 040; nëntor 168 476; dhjetor 211 365.

¹⁶ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 33, fl. 1. Mbi krijimin e Fondit të Paprekshëm në valutë të lirë, nr. 202, datë 9 prill 1960.

¹⁷ *Po aty*.

¹⁸ *Po aty*.

¹⁹ *Po aty*, fl. 2. "Kursi i këmbimit dollar/lek për vitin 1960 sipas Bankës së Shtetit Shqiptar ishte: 1\$=5 lekë"; *po aty*, fl. 7.

edhe minimalisht ekonominë e Shqipërisë, mbaheshin stok, për t'u përdorur ndoshta vetëm për nevojat e udhëheqjes së lartë të vendit.

Megjithatë, Banka e Shtetit jepte raporte optimiste duke premtuar se për vitin 1960, fondi rezervë do të ishte 600 000 dollarë, pra 150 mijë më shumë nga sa ishte parashikuar.²⁰ Por, mungesat e Shqipërisë në grurë kishin bërë që ky fond të prekej pa u stivuar mirë. Sipas raportit të Bankës, Shqipëria kishte blerë grurë nga Anglia në masën 7 mijë ton duke paguar 450 mijë dollarë.²¹ Për të treguar se nuk "bënin tregti" me vendet kapitaliste dhe se ishin parimorë, Banka njoftonte se gruri i marrë nga Anglia ishte nga RDGJ-ja, por që ishte eksportuar në Angli dhe do të mbërrinte në Shqipëri më 30 nëntor 1960.²² Banka e Shqipërisë parashikonte se plani ishte tejkaluar sipas një përqindjeje të mirë dhe kjo do të ndihmonte në shlyerjen e detyrimeve financiare karshi vendeve perëndimore, që këto të fundit të "kuptonin" korrektesën e Shqipërisë.²³ Teprica prej 232 931 dollarë, që kishte mbetur e papërdorur nga importimi i grurit nga Bashkimi Sovjetik, do të kalonte në fondin rezervë.²⁴

Deri në mbledhjen e Bukureshtit për të cilën kam shkruar më parë,* Shqipëria përkrahte çdo nismë sovjetike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjithashtu, Shqipëria nuk linte rast pa ngritur në qiell miqësinë dhe lidhjen e pathyeshme vëllazërore me Bashkimin Sovjetik. Më 2 qershor 1960, qeveria e Bashkimit Sovjetik i dërgoi Shqipërisë deklaratën lidhur me propozimet sovjetike për çarmatim të përgjithshëm bërthamor.²⁵ Në këtë deklaratë të nënshkruar nga Nikita Hrushovi, jepeshin rekomandimet sovjetike lidhur me çarmatimin e përgjithshëm botëror dhe njëkohësisht shpreheshin dyshimet se fuqitë perëndimore të përfaqësuara në OKB nuk e dëshironin çarmatimin.²⁶ Në fund të letrës drejtuar Kryeministrit shqiptar Shehu, Hrushovi shprehte bindjen se qeveria e RPSH-së do të

²⁰ *Po aty*, fl. 4. Mbi përdorimin e valutës së lirë në Perëndim.

²¹ *Po aty*, fl. 3.

²² *Po aty*, fl. 4.

²³ *Po aty*.

²⁴ *Po aty*, fl. 6.

* Shih artikullin tim të botuar në revistën *Shejzat*, Gjon Boriçi, "Forgetting the Soviet Union but 'loving' China. Albania's foreign policy on 1960", Year VI, January-June, (Tiranë: 2021), 205-226.

²⁵ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1317, fl. 3. Propozimet e qeverisë sovjetike mbi dispozitat kryesore të marrëveshjes për një çarmatim të përgjithshëm dhe të plotë.

²⁶ *Po aty*, fl. 6.

përkrahte qëndrimet sovjetike.²⁷ Përgjigjja nga ana e Këshillit të Ministrave të RPSH-së nuk mungoi. Vetëm gjashtë ditë më pas, më 8 qershor 1960, qeveria shqiptare u deklarua hapur dhe pa rezerva në mbështetje të nismës sovjetike për çarmatimin e përgjithshëm botëror.²⁸

Shqipëria varej nga BS jo vetëm nga ndihmat dhe kreditë, por edhe nga trajnimi i agjentëve të Sigurimit të Shtetit. Më 16 janar 1960, Kryeministri shqiptar Mehmet Shehu i kishte dërguar një kërkesë tepër sekrete Hrushovit, lidhur me pranimin në Bashkimin Sovjetik në shkollën e zbulimit të një grupi prej 15 oficerësh shqiptarë të Sigurimit.²⁹

Qeveria e Shqipërisë megjithëse deklaronte me të madhe se vendi kishte arritur suksese të mëdha në ndërtimin e socializmit, përsëri shtrinte dorën si një lypsare e vërtetë për të marrë ndihma dhe kredi nga BS-ja. Më 21 korrik 1960, qeveria shqiptare i parashtroi qeverisë së BS-së kërkesën e re që t'i akordohej 50 000 ton grurë për vitin 1960.³⁰ Këtë kërkesë, Mehmet Shehu në emër të qeverisë shqiptare e justifikoi se viti 1959 ishte viti më i keq për bujqësinë e vendit dhe shirat e shumta kishin vonuar mbjelljen e të lashtave dhe si rezultat prodhimi do të realizohej në masën 83%.³¹ Përpara një situatë të tillë, sipas Shehut, rrezikohej sigurimi i bukës së popullit dhe prandaj e kishte të nevojshme t'i lutej qeverisë së Bashkimit Sovjetik që të kishte mirësinë t'i akordonte Shqipërisë 50 000 ton grurë për periudhën gusht-dhjetor 1960.³² Si për

²⁷ *Po aty*.

²⁸ *Po aty*, fl. 35. Pjesë nga deklarata e qeverisë shqiptare: "Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, duke shprehur vullnetin e popullit paqedashës shqiptar i cili ka vuajtur aq shumë nga luftërat e së kaluarës, mbështet fuqimisht propozimet e reja sovjetike". Këshilli i Ministrave i Republikës Popullore të Shqipërisë, Tiranë, më 8 qershor 1960.

²⁹ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1318, fl. 2. Kërkesë për dërgim oficerësh nga Ministria e Punëve të Brendshme në Bashkimin Sovjetik. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, i lutet Qeverisë së Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, që të pranojë në shkollën 3 vjeçare të K/zbulimit të Komitetit të Sigurimit të Shtetit pranë Këshillit të Ministrave 15 oficerë".

³⁰ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1319, fl. 1. Letër Këshillit të Ministrave të Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, Tiranë, 21 korrik 1960.

³¹ *Po aty*. Pjesë nga letra e Mehmet Shehut: "Shira të shumtë më shumë se çdo vit tjetër, kanë vazhduar pa ndërprerje gjithë vjeshtën e vitit 1959, gjithë dimrin dhe gjer në fund të muajit maj të vitit 1960, duke shkaktuar kështu një vonesë të jashtëzakonshme për të gjitha mbjelljet e pranverës".

³² *Po aty*, fl. 2. "Duke marrë parasysh se ky vit i keq bujqësor do të sjellë vështirësi të paevitueshme për ne në bilancin e tregtisë së jashtme si të vitit në vazhdim, ashtu edhe

ironi të fatit, kërkesa për të siguruar "bukën e popullit" nuk do t'i ndahej qeverisë shqiptare deri në bisedimet e fundit me Kinën të vitit 1975.³³

Shqipëria edhe gjatë vitit 1960, nuk i ndali kërkesat e saj për kredi ndaj vendeve të Kampit Socialist. Pa kaluar dy vjet nga kërkesat e shumta për kredi të vitit 1958, kreditë që iu kërkuan vendeve të këtij kampi për vitin 1960 justifikoheshin për domosdoshmërinë që kishin për të ngritur nivelin e jetesës së popullit shqiptar.³⁴ Kërkesës për kredi nga ana e Shqipërisë, BS iu përgjigj më 25 prill 1960.³⁵ Qeveria sovjetike me anë të Kryeministrit Hrushov, iu përgjigj me dashamirësi kërkesës së qeverisë shqiptare dhe e quante të mundshme shtyrjen e shlyerjes nga ana e Shqipërisë të kredive që i kishte dhënë Bashkimi Sovjetik për vitet 1960-1965 për 10-15 vjet.³⁶

Për të ngritur nivelin e jetesës së popullit shqiptar, KQ i PPSH-së me anë të Sekretarit të Parë Enver Hoxha, iu drejtua me një kërkesë thujtse të njëjlojtë edhe kryetarit të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane të RDGJ-së Valter Ulbriht, më 29 prill 1960.³⁷ Në letrën e tij, Enver Hoxha, shprehte shqetësimin se për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë shqiptare, vendi kishte një nivel shumë të ulët të mekanizimit të këtij sektori dhe nuk ishte në gjendje të kryente detyrat e ngutshme që i

për vitin e ardhshëm, propozojmë që për shlyerjen e kundërvlerës së 50 000 ton grurë që përmendet më sipër, të përdoret pjesa përkatëse e ratave të kredive që duhej të shlyente Qeveria jonë gjatë viteve 1960 dhe 1961, pagesa e të cilave është pranuar nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik që të shtyhet për një periudhë kohe prej 10-15 vjetësh".

³³ Gjon Boriçi, "Kredia e fundit kineze për Shqipërinë, 1974-1975", në *Studime historike*, nr. 1-2, (Tiranë: Instituti i Historisë i Akademisë së Studimeve Albanologjike, 2018), 263.

³⁴ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1320, fl. pa numër. Letrat e K.Q. të PPSH-së drejtuar Komiteteve Qendrore të PK të Bashkimit Sovjetik, PSB Gjermane dhe PK Çekosllloake për dhënie kredie për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.

³⁵ *Po aty*, fl. 1.

³⁶ *Po aty*. Pjesë nga letra e Hrushovit: "Ne e kuptojmë preokupimin tuaj për gjendjen e nivelit të jetesës së popullit shqiptar dhe aspiratën për të kapërcyer vështirësitë që keni me anën e përpjekjeve të përbashkëta dhe të ndihmës vëllazërore të vendeve socialiste. Për të ndihmuar RPSH-në në blerjen e mallrave të konsumit popullor dhe të materialeve për ndërtim banesash, Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik e quan të mundshme të shtyjë shlyerjen nga ana e Shqipërisë të kredive që i ka dhënë më parë Bashkimi Sovjetik nga vjetët 1960-1965 për 10-15 vjet, duke pasur parasysh, që pala shqiptare, po ta quajë të nevojshme, do të mund të shfrytëzojë këtë shumë për blerjen e mallrave dhe materialeve të nevojshme".

³⁷ *Po aty*, fl. 3.

paraqiteshin.³⁸ Sipas Enver Hoxhës, niveli i tërheqjes në bujqësi ishte ende në gjendjen e paraluftës dhe përmirësimi i saj varej nga shtimi i numrit të traktorëve, pasi puna në bujqësi në shumicën e saj bëhej ende me krahë.³⁹ Për këtë arsye, Komiteti Qendror i PPSH-së i kërkonte RDGJ-së akordimin e një kredie prej 25 milionë rublash për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965 me afat shlyerjeje nga viti 1981 e më pas.⁴⁰

Përveç letrës dërguar Valter Ulbrihtit, Enver Hoxha iu drejtua me një tjetër letër Kryetarit të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë Antonin Novotni, për akordim kredie për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.⁴¹ Shuma e kredisë që iu kërkua edhe Çekosllovakisë ishte e njëjtë me atë të RDGJ-së, 25 milionë rubla me afat shlyerjeje nga viti 1981 e tutje.⁴²

Më 30 prill 1960, Enver Hoxha iu drejtua me një tjetër letër Nikita Hrushovit,⁴³ ku ndryshonte vetëm pjesa e kërkesës për kredi. Kredia që i kërkoi Enver Hoxha liderit sovjetik ishte marramendëse. Hoxha kërkoi 300 milionë rubla kredi të ndarë në 250 milionë rubla për mekanizimin e bujqësisë dhe 50 milionë rubla për plehra kimike me afat shlyerjeje nga viti 1981 e më pas, për periudhën 1960-1965 duke përfshirë edhe vitin

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Po aty*, fl. 4.

⁴⁰ *Po aty*, fl. 5. Pjesë nga letra e Enver Hoxhës drejtuar Valter Ulbrihtit: "Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, duke shqyrtuar me kujdes të veçantë vështirësitë e mëdha që paraqiten në sektorin e bujqësisë të cilat, sikurse dihet, influencojnë drejtpërdrejt në nivelin e jetesës së popullit tonë që vazhdon të jetë shumë i ulët, si dhe mundësitë reale për të kapërcyer këto vështirësi, e ndjen veten të detyruar që t'i drejtohet Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane dhe Qeverisë së Republikës Demokratike Gjermane për t'i akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë një kredi me afat të gjatë prej 25 milion rublash (në makina të ndryshme bujqësore dhe në pleh kimik sipas listës së bashkangjitur) për periudhën 1961-1965, me shlyerje nga viti 1981 e tutje. Kjo është vetëm një pjesë e ndihmës që kërkojmë, pse nevojat tona për mekanizimin e bujqësisë dhe përdorimin e plehrave kimikë janë shumë më të mëdha".

⁴¹ *Po aty*, fl. 8. Letër e Enver Hoxhës drejtuar Antonin Novotnit, 29 prill 1960.

⁴² *Po aty*, fl. 10. Pjesë nga letra e Enver Hoxhës drejtuar Antonin Novotnit: "...e ndjen veten të detyruar t'i drejtohet Komitetit Qendror të Partisë Komuniste Çekosllovake dhe Qeverisë Çekosllovake për t'i akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë një kredi me afat të gjatë prej 25 milionë rublash (në traktorë, makina bujqësore dhe vegla të ndryshme shkëmbimi sipas listës bashkangjitur), për periudhën 1961-1965, me shlyerje që nga viti 1981 e tutje. Kjo është vetëm një pjesë e ndihmës që kërkojmë, pse nevojat tona për mekanizimin e bujqësisë janë shumë më të mëdha".

⁴³ *Po aty*, fl. 13. Letër e Enver Hoxhës drejtuar Nikita Hrushovit, Tiranë, 30 prill 1960.

1960.⁴⁴ Kredia e re që kërkonte Enver Hoxha do ta rëndonte edhe më shumë ekonominë tepër të dobët shqiptare. Në fund të letrës prej katër faqesh, Hoxha shprehte besimin se Bashkimi Sovjetik do t'i përgjigjej në mënyrë dashamirëse dhe pozitive kërkesës së Shqipërisë.⁴⁵

Shqipëria, nga kreditë e shumta që u kishte kërkuar gjatë vitit 1958 të gjitha vendeve të Kampit Socialist, ishte e dukshme se nuk kishte asnjë mundësi shlyerjeje dhe përsëri kërkonte të reja. Duke parë rëndësinë e situatës dhe duke mos pasur më mundësi për të kërkuar një kredi të re, qeveria e RPSH-së iu drejtua me një letër qeverisë së Republikës Popullore të Hungarisë që të shihte mundësinë e shtyrjes së afatit për pagimin e kredisë nga ana e Shqipërisë.⁴⁶ Në letrën e 29 dhjetorit 1960, Kryeministri Mehmet Shehu, iu drejtua homologut të tij hungarez Ferenc Mynih, ku i kërkonte që shlyerja e kredive së bashku me kamatat përkatëse të kryhej në masën 30% për vitet 1966-1969, dhe kredia e re e akorduar nga bisedimet përkatëse prej 20 milionë rublash e akorduar nga Hungaria për Shqipërinë për periudhën 1961-1965, të shlyhej në vitet 1970-1977.⁴⁷ Gjithashtu, Kryeministri Shehu i kërkonte homologut të tij Mynih, që për kreditë ekzistuese, së bashku me kamatat përkatëse, shlyerja të kryhej në masën 30% për vitet 1970-1974 dhe 70% për vitet 1975-1982.⁴⁸ Për kredinë e akorduar për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965 që ishte në masën 20 milionë rubla, shlyerja të kryhej në tetë këste vjetore për vitet 1975-1982.⁴⁹ Aplikimin e kësaj metode, Kryeministri Shehu e justifikoi me faktin se vetëm në këtë mënyrë RPSH-ja do të ishte në gjendje të përballonte shlyerjen e kredive të akorduara nga Republika Popullore e Hungarisë.⁵⁰

⁴⁴ *Po aty*, fl. 15.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 16. Pjesë nga letra e Enver Hoxhës drejtuar Nikita Hrushovit: "Ne e sigurojmë Komitetin Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik se do të vëmë të gjithë forcat tona për të merituar ndihmën tuaj vëllazërore dhe bujare për lumturinë e popullit tonë dhe për forcimin e miqësisë së pathyeshme dhe të sinqertë midis dy vendeve tona".

⁴⁶ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1326, fl. 1. Mbi afatet e shlyerjes së kredive të marra gjer më sot dhe ato të pesëvjeçarit të tretë.

⁴⁷ *Po aty*.

⁴⁸ *Po aty*, fl. 2.

⁴⁹ *Po aty*.

⁵⁰ *Po aty*.

Përgjigjja që i erdhi qeverisë shqiptare nga kryeministri hungarez ishte shumë dekurajuese. Përgjigjja erdhi më 4 shkurt 1961,⁵¹ kur po forcohej dita-ditës ftohja e marrëdhënieve të Shqipërisë me të gjitha vendet e Kampit Socialist pas Mbledhjes së Moskës në nëntor 1960.⁵² Shlyerja e kredive nuk do të pësonte ndryshime sipas kryeministrit hungarez si shkak i gjendjes ekonomike të Hungarisë, e cila duhej të shlyente për vete kreditë e marra nga vendet e Kampit Socialist pas kundërrevolucionit, siç e quante ai.⁵³ Hungaria i jepte Shqipërisë një ndihmë në kredi në masën 15 milionë rubla dhe një kredi tjetër në masën 20 milionë rubla dhe fillimi i shlyerjes së tyre të fillonte nga viti 1966.⁵⁴ Afati i shlyerjes së kredive përfshinte vitet 1966-1977 dhe për këtë afat nuk do të kishte ndryshime.⁵⁵ Shqipëria duhej të paguante dhe për këtë nuk mjaftonin më fjalët e bukura për ndihmë vëllazërore ndërmjet vendeve të Kampit Socialist.

Në një raport të Bankës së Shtetit Shqiptar më datë 2 qershor 1960, gjendja e Shqipërisë gjatë gjithë dekadës 1951-1960 për sa i përkiste situatës valutore ishte tragjike. Sipas evidencave të Bankës së Shtetit Shqiptar, gjendja e të ardhurave jotregtare për vitet 1951-1955 ishte 79 699 000 rubla.⁵⁶ Shpenzimet jotregtare për vitet 1951-1955 ishin në masën 80 083 000 rubla.⁵⁷ Si pasojë e kredive të marra në gjysmën e dytë të viteve 50-të, dhe saktësisht për vitet 1956-1960, deviza në valutë ishte në masën 127 181 000 rubla.⁵⁸ Nga lëvrimi dhe përdorimi i kredive të marra, krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve ishte në kufijtë e

⁵¹ *Po aty*, fl. 6. Përgjigjja e Kryeministrit hungarez dr. Ferenc Mynih drejtuar Kryeministrit shqiptar Mehmet Shehu. Budapest, 4 shkurt 1961.

⁵² Gjon Boriçi, "Forgetting the Soviet Union but 'loving' China...", 218-223.

⁵³ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1960, D. 1326, fl. 6.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ *Po aty*. Pjesë nga letra e Kryeministrit hungarez dr. Mynih mbi afatet e shlyerjes së kredive nga ana e Shqipërisë: "1) 80 milionë rubla me interesin e tyre do të shlyhen: 30% në vitet 1966-1969, ndërsa 70% në vitet 1970-1977, çdo vit me shuma të barabarta. 2) 20 milionë rubla me interesat e tyre do të shlyhen: 30% në vitet 1966-1969, ndërsa 70% në vitet 1970-1977, çdo vit me shuma të barabarta".

⁵⁶ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 34, fl. 1. Të ardhurat e devizave dhe valutave për veprimet jotregtare për periudhën 1951-1955 dhe realizimet përkatëse të tyre.

⁵⁷ *Po aty*.

⁵⁸ *Po aty*.

barazisë, por edhe këto ishin të pamjaftueshme pasi duheshin shlyer kreditë.⁵⁹

Detyrime të mëdha financiare ndaj vendeve të Kampit Socialist

Kreditë që kishte marrë Shqipëria nga vendet e Kampit Socialist gjatë viteve 50-të, kishin luajtur një rol shumë të rëndësishëm në konsolidimin e pushtetit komunist të Enver Hoxhës. Pa to, do të ishte e pamundur mbijetesa e tij dhe e regjimit që ai përfaqësonte. Megjithatë, Shqipëria kishte të tjera probleme. Më 10 mars 1960, qeveria shqiptare njoftohet se plani i masave mbi mbarëvajtjen e furnizimit të popullsisë me ushqime dhe të tjera materiale artikujsh industrialë, kishte pasur mangësi të mëdha.⁶⁰ Planin e Plenumit të Komitetit Qendror i datës 16 korrik 1957 për përmirësimin e furnizimit të popullsisë me ushqime, dukej qartë se kishte dështuar.⁶¹ Ekonomia e vendit sidomos dikasteret e Tregtisë, Bashkimit Qendror të Kooperativave dhe Ndërmarrja Shtetërore e Furnizimit të Popullsisë (NSHFP) gjatë vitit 1959 kishin marrë shuma të mëdha në lekë për të përmirësuar punën e tyre, por rezultatet kishin qenë negative.⁶² Sipas raportit, ndërmarrjet e lartpërmendura nuk kishin qenë në gjendje t'i përgjigjeshin fuqisë blerëse të popullatës.⁶³ Arsyet e vërteta të këtyre mungesave që kishte filluar të ndiente tregu i brendshëm në Shqipëri, ishin të tjera. Duke qenë se Ministria e Tregtisë ishte vënë në qendër të vëmendjes dhe ishte kritikuar më 30 maj 1960 për këto mangësi edhe nga zëvendëskryeministri i parë, Spiro Koleka,⁶⁴ më 22 qershor 1960, në një informacion dërguar Kryeministrisë nga ministri Kiço Ngjela, vendi do të kishte shumë probleme në faturimin e industrive të

⁵⁹ *Po aty*. "Të ardhurat dhe shpenzimet jo tregtare të kryera me shtetet e Kampit tonë, duke filluar nga viti 1956 janë përlllogaritur me koeficientin për t'u kthyer në të ardhura dhe shpenzime tregtare, të cilat paraqiten si më poshtë...shuma (të ardhura) 33 684 000 rubla; (shpenzime) 19 731 000 rubla; diferenca 13 953 000 rubla".

⁶⁰ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 56, fl. 1, 2. "Të meta të cilat kanë influencuar negativisht në plotësimin e nevojave të popullatës si dhe në realizimin e xhiros së tregtisë socialiste".

⁶¹ *Po aty*, fl. 2.

⁶² *Po aty*. Sipas raportit për planin e vitit 1959 Ministria e Tregtisë kishte marrë një shtesë prej 270 milionë lekë, Bashkimi Qendror i Kooperativave të Konsumit 470 milionë lekë dhe N.SH.F.P.-ja 60 milionë lekë.

⁶³ *Po aty*, fl. 3.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 7/1.

reja që do të vinin nga vendet e Kampit Socialist.⁶⁵ Ministri Ngjela nuk mund ta thoshte hapur se pagesat që kryente Shqipëria të borxheve të marra si pasojë e kredive ndaj Kampit Socialist, ishin faktorët kryesorë të mungesave të artikujve më të domosdoshëm në tregun shqiptar.⁶⁶ Ministri Ngjela, në letrën e tij sqaruese dhe informuese e vinte theksin te harxhimet e mëdha në industri, veçanërisht në atë të rëndë. Sipas kësaj letre, praktika e deritanishme kishte vërtetuar se faturimi i industrive të reja kishte specifikime të shumta dhe në shumë raste vinin me vonesë dhe kërkonin shumë kohë që të përktheheshin.⁶⁷ Shuma fillestare, e cila kërkohej për të rregulluar pezullimin e likuidimit të objekteve që do të ndërtoheshin nga vendet e Kampit Socialist, do të ishte sipas ministrit Ngjela 100 milionë lekë.⁶⁸ Ministri shqiptar kërkonte me ngulm zgjidhjen e këtij problemi, pasi nuk mund të kryheshin pagesat pa pasur specifikimet.⁶⁹

Duket se pas mbledhjes së Bukureshtit, Shqipërisë dalëngadalë po i mbylleshin të gjitha burimet financiare. Më 8 gusht 1960, sektori i financës së Kryeministrit paraqiti një informacion të detajuar se sa do të

⁶⁵ *AQSH*, F. 490/KM, V. 1960, D. 862, fl. 1. Mbi faturimin e industrive të reja që vijnë nga Demokracitë Popullore.

⁶⁶ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 60, fl. 2, 5. "Nga të dhënat që kemi marrë nga disa Degë banke, rezulton se furnizimi i popullatës me artikuj ushqimorë gjatë stinës së dimrit (mish, patate, qepë, fruta, zarzavate, agrume etj.) ka patur mjaft mungesa...Nga të dhënat që kemi marrë prej disa degëve të Bankës, rezulton se plani i grumbullimit të drithërave dhe tregtimi i miellrave e i bukës në vitin 1959 është bërë me të meta".

⁶⁷ *Po aty*, F. 490/KM, V. 1960, D. 862, fl. 1. Pjesë nga letra: "Praktika e deritashme ka vërtetuar se faturimi i industrive të reja të ardhura nga Demokracitë Popullore, nuk mund t'i përgjigjet urdhërit tuaj Nr. 14/150 datë 9/12/1959 për faktin se specifikimet që kërkohej jo vetëm se vijnë me vonesë dhe në disa raste mungojnë, por kryesorja është se këto në rast se do të përfshihen në fakturë, kërkojnë një punë voluminoze si në drejtim të përkthimit të tyre, ashtu dhe në punën materiale për përkthimin dhe llogaritjet e tyre. Kjo është në pamundësi praktike të kryhet sepse në shumicën e rasteve një fakturë me një vlefte të caktuar, ka aq shumë specifikime që arrijnë deri në 100 faqe të daktilografuara. Nga ana tjetër ka raste që specifikimet nuk kanë çmimin dhe vlefte të përkatëse".

⁶⁸ *Po aty*, fl. 1/1.

⁶⁹ *Po aty*. Pjesë nga letra e Kiço Ngjelës: "Mbetemi në pritje të zgjidhjes së këtij problemi mbasi Ministria e Minierave dhe ajo e Industrisë kanë urdhëruar ndërmarrjet e tyre që të mos likujdojnë fakturat e industrive të reja pa patur specifikime. Kjo do të shkaktojë rritjen e debitorëve të cilat në këto kondita do të mbeten pa shpresa arkëtimi".

ishin pagesat që do të kryente Shqipëria ndaj vendeve të demokracive popullore.⁷⁰ Nga data 1 janar deri më 30 qershor 1960, kreditë e akorduara nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracive popullore ishin përdorur në shumën 54 474 614,30 rubla.⁷¹ Ajo çfarë ishte më e rëndë dhe tepër shqetësuese, ishte fakti se përqindjet e interesave të kredive ndaj vendeve të Kampit Socialist e kishin rritur detyrimin financiar të Shqipërisë ndaj këtyre vendeve në shumën 801 485 075,14 rubla.⁷² Detyrimi i Shqipërisë në marrëveshjet me klering ndaj vendeve të demokracive popullore kapte shifrën 81 750 778,70 rubla.⁷³ I vetmi përfitim (nëse mund ta quajmë kështu) që kishte pasur Shqipëria ishte nga veprimet jotregtare me të ardhura neto 12 255 566 rubla në favor.⁷⁴

Nga mungesa e vendosjes së çmimeve përfundimtare, për importimin e mallrave nga Perëndimi, ekonomia shqiptare kishte një debit prej 778 000 dollarë të marrë nga fondi neto i vënë në dispozicion me të njëjtën shumë.⁷⁵ Nga të gjitha këto detyrime, vetëm me Bashkimin Sovjetik, Çekoslovakinë, Hungarinë dhe Poloninë për gjashtëmuorin e parë të vitit 1960, Shqipëria detyrohej të paguante vetëm për importet 549 483,84 rubla dhe për eksportet 696 319,53 rubla.⁷⁶ Mungesa e vendosjes së çmimeve përfundimtare, kishte bërë të mundur që Shqipëria për periudhën janar-qershor 1960 të kishte një përfitim modest prej 278 000 dollarësh.⁷⁷

Edhe pse situata financiare e Shqipërisë siç shihet nga këto fakte ishte thujse totalisht negative, shifrat e kredive që kishte marrë për këtë gjashtëmuor (janar-qershor 1960) ishin tepër të mëdha për vendin t'i përballonte. Nga Çekoslovakia më 7 mars 1960 ishte akorduar një kredi që nuk pasqyrohet se sa ishte shuma, pasi nuk kishte çmime definitive; 40 milionë rubla ishin akorduar nga RDGJ-ja, 20 milionë rubla nga Hungaria, 20 milionë rubla nga Bullgaria, 10 milionë rubla nga Polonia, 30 milionë rubla nga Rumania dhe 55 milionë rubla nga Kina.⁷⁸ Për

⁷⁰ *Po aty*, fl. 3.

⁷¹ *Po aty*.

⁷² *Po aty*.

⁷³ *Po aty*. Pasqyra e plotë përmbledhëse e këtij dokumenti ndodhet në fletën 6 të kësaj dosjeje.

⁷⁴ *Po aty*.

⁷⁵ *Po aty*, fl. 3/1.

⁷⁶ *Po aty*, fl. 4/1.

⁷⁷ *Po aty*, fl. 5.

⁷⁸ *Po aty*, fl. 9-10.

bilancin e pesëvjeçarit të tretë nga qeveria shqiptare ishte parashikuar që t'i kërkohej Kinës edhe 30 milionë rubla kredi, për blerje gruri, shlyerjen e deficitit të vitit 1960 me Bullgarinë ku me këtë të fundit duhej përcaktuar afati i shlyerjes dhe përqindja e interesave.⁷⁹

Reagimi i Bashkimit Sovjetik ndaj qëndrimit shqiptar në Mbledhjen e Moskës dhe arsyet e shkëputjes së butë të Shqipërisë nga orbita sovjetike

Harku kohor (qershor-nëntor) në gjysmën e dytë të vitit 1960, do të ishte tronditës për politikën shqiptare dhe një ndryshim rrënjësor i politikës së jashtme të RPSH-së.⁸⁰ Mbledhja e Bukureshtit e cila shënoi edhe ndarjen e thellë brenda Kampit Socialist në dy pole të mëdha (Moskë dhe Pekin) dhe mbi të gjitha fjalimi i Enver Hoxhës në Moskë, më 16 nëntor 1960, pa dyshim që nuk do të anashkaloheshin lehtë nga Bashkimi Sovjetik. Ndoshta, nuk ishte i pritshëm ndonjë invazion sovjetik i Shqipërisë i stilit gjermano-lindor, polak apo hungarez, por reagim do të kishte. Me Shqipërinë, Bashkimi Sovjetik e kishte të thjeshtë të merrej, pasi e kishte në dorë financiarisht. Kreditë sovjetike që i ishin akorduar shtetit shqiptar që nga viti 1945, e bënin domosdoshmërisht të pranishëm Bashkimin Sovjetik në vendin e vogël ballkanik. Për largimin e Shqipërisë nga orbita sovjetike, është spekuluar jo pak. Spekulumi më "i famshëm" është ai i mitizimit të figurës së Enver Hoxhës nga nostalgjikët e tij dhe jo vetëm nga ata, të cilit sipas tyre nuk iu "drodh qerpiku" para Hrushovit në Moskë.

Për Bashkimin Sovjetik, Shqipëria ishte si një "guriçkë" në këpucë, që të bezdis, por nuk të gjakos. Thjesht duhet të heqësh këpucën, ta kthesh përmbys që të dalë guri jashtë dhe pastaj ta mbathësh e të vazhdosh rrugën. Shqipëria ishte një shtet që kërkonte ndihma dhe kredi jo vetëm nga Bashkimi Sovjetik. E drejtuar nga një udhëheqje e paaftë politike dhe jashtë çdo lloj përfytyrimi për të kuptuar marrëdhëniet ndërkombëtare, sa më parë të largohej nga aleanca me Kampin Socialist të drejtuar nga Bashkimi Sovjetik, aq më mirë do të ishte për këtë kamp.

⁷⁹ *Po aty.*

⁸⁰ Lidhur me ndryshimin e politikës së jashtme të Shqipërisë dhe ndryshimin e kursit politik të Enver Hoxhës nga Bashkimi Sovjetik në drejtim të Kinës, shih: Gj. Boriçi, "Forgetting the Soviet Union but...", 205-226.

Por jo menjëherë. Do të përpiqem të tregoj bazuar në dokumente autentike disa prej tyre, të cilat prezantohen për herë të parë, se përse Bashkimi Sovjetik e la aq butë Shqipërinë të largohej dhe të lidhej me Kinën.

Në fakt, Moska kishte filluar t'ia shtrëngonte lakun ekonomikisht Shqipërisë dhe nuk do të priste gjatë që ky vend i vogël ta mbante pezull pa i kthyer paratë që i kishte marrë BS-së. Në datën 11 nëntor 1960 (pesë ditë përpara fjalimit "zulumadh" të Enver Hoxhës në Moskë), ministri sovjetik i Financave, V. Garbuzov, i dërgoi një letër homologut të tij shqiptar, Aleks Verli, në të cilën e njoftonte zyrtarisht mbi vendimin e Bashkimit Sovjetik për të rritur kursin e këmbimit të rublës duke filluar nga 1 janari 1961.⁸¹ Në letër, gjithashtu, ministri sovjetik njoftoi se tashmë kursi i këmbimit do të ishte 10 me 1 (rubël) dhe se detyrimet financiare reciproke të vendeve përkatëse (Shqipërisë ndaj Bashkimit Sovjetik) do të pësonin ndryshim në shprehjen e tyre në rubla.⁸² Në të njëjtën përmbajtje ishte edhe letra e datës 12 nëntor 1960, që ministri Verli mori nga S. Skackov, Kryetar i Komitetit Shtetëror për Lidhjet e Jashtme Ekonomike pranë Këshillit të Ministrave të BRSS-së. Në letër, Skackovi, njoftonte se edhe pasi të kishte ndodhur ndryshimi, pagesat e Shqipërisë do të ruheshin në nivelin ekzistues.⁸³

Ky njoftim ishte një fakt alarmues për financat shqiptare. Në raportin që ministri Verli u dërgoi të gjitha ministrive dhe Drejtorisë së Tregtisë Financës të Komitetit Qendror të PPSH-së në nëntor të 1960-s, informoi me detaje ndryshimet që do të pësonin marrëdhëniet tregtare ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik.⁸⁴ Sipas informacionit të ministrit Verli, kursi i këmbimit ndërmjet rublës dhe dollarit do të ishte 0.90 rubla=1 dollar.⁸⁵ 100 rubla të vjetra tregtare do të ishin baras me 22,5 rubla të reja tregtare, d.m.th. në dukje zvogëlohej rubla me 77,50%.⁸⁶ Prej datës 1 janar 1961, zhvillimi i marrëdhënieve tregtare të Shqipërisë me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera do të bëhej në bazë të këmbimit me rubla të reja. Shqipëria duhej të bazohej tashmë në

⁸¹ AQSH, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 36, fl. 1. Mbi rritjen e kursit të rublës ndaj valutave të huaja.

⁸² Po aty.

⁸³ Po aty, fl. 2.

⁸⁴ Po aty, fl. 3.

⁸⁵ Po aty.

⁸⁶ Po aty.

këmbimin e ri të rublës për të kryer çdo pagesë krediti, apo për të importuar mallra nga Bashkimi Sovjetik dhe nga çdo vend tjetër i Kampit Socialist.⁸⁷ Në pamje të parë, Shqipëria ishte më e avantazhuar nga kjo lëvizje e Moskës, por kursi i këmbimit tani ishte fundosës për vendin pasi 1 rubël (e re)=55,55 lekë sipas ministrit shqiptar.⁸⁸ Ndërsa kursi i lekut me dollarin amerikan për momentin mbetej i pandryshueshëm: 1 dollar=5,0 lekë.⁸⁹

Tashmë, çdo kredi e papaguar nga ana e Shqipërisë do të paguhej duke marrë për bazë kursin e ri të rublës dhe gjithashtu do të rivlerësoheshin tepricat e llogarive të kredive në rubla të shumave përkatëse të pagesave me afat dhe të titujve të detyrimit të tyre.⁹⁰ Ishte shumë e dukshme se ndryshimi i kursit të ri të këmbimit me rublën do të rezultonte katastrofik për ekonominë e Shqipërisë. Fjalimi i Enver Hoxhës po jepte dalëngadalë "frytet" e veta. Vetë ministri shqiptar i Tregtisë, Kiço Ngjela, dha i pari alarmin për këtë fakt kur, më 26 nëntor 1960, njoftoi se kishte marrë një letër nga ministri i Tregtisë së Jashtme i BS-së, N. Patoliçev, ku njoftohej se volumi lidhur me pagesat dhe shpenzimet do të bëhej sipas kursit të ri.⁹¹ Në një letër që i ishte dërguar Bankës së Shtetit në Bashkimin Sovjetik nga Iljaz Fishta i cili ishte caktuar nga shteti shqiptar së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Bankës, Spiro Bakalli, për të kryer negociatat e nevojshme në kryeqytetin sovjetik për këtë ndryshim, Shqipëria shfaqti shqetësimin e saj se do t'i duhej të paguante më shumë nga sa ishin marrëveshjet e kredive mes dy vendeve.⁹² Sipas kësaj letre, Shqipërisë i rriteshin me dhjetëfish pagesat

⁸⁷ *Po aty*, fl. 4/1.

⁸⁸ *Po aty*.

⁸⁹ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 33, fl. 7. Krijimi i Fondit të Paprekshëm në valutë të lirë.

⁹⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 36, fl. 9. Letër e drejtorit të Bankës së Shtetit të B.R.S.S.-së A. Korovushkin dërguar Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar, Spiro Bakalli, Moskë, 11 nëntor 1960.

⁹¹ *Po aty*, fl. 26, 27.

⁹² *Po aty*, fl. 30. "Gjatë diskutimeve tona për caktimin e kursit zyrtar midis lekut dhe rublës së re sovjetike, nuk u gjendëm të një mendimi mbasi pala Juaj, niset nga fakti se kursi zyrtar prej lek 12.50 për një rublë të vjetër të shumëzohet me dhjetëfishin duke bërë kështu që ky të jetë lek 125 për një rublë të re"; shih edhe fl. 53. Iljaz Fishta ishte i ngarkuari i Bankës së Shtetit Shqiptar për të zhvilluar diskutimet së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Bankës, Spiro Bakalli. Ata mbërritën në Moskë më datë 27 dhjetor 1960 dhe një ditë më pas (28 dhjetor) zhvilluan bisedimet përkatëse me palën sovjetike".

në rubla. Shqipëria kërkonte që kursi zyrtar i këmbimit mes lekut dhe rublës (1 rubël [e vjetër]=12.50 lekë) të mbetej i pandryshuar edhe për faktin se leku shqiptar nuk kishte një paritet të shpallur në ar, dhe kjo sipas palës shqiptare ishte përcaktuar në rrugë indirekte dhe ishte pranuar prej Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të Kampit Socialist.⁹³ Sipas letrës, Shqipëria po bënte përpjekje të jashtëzakonshme për të forcuar ekonominë dhe lekun shqiptar dhe ky veprim i palës sovjetike do ta dëmtonte rëndë monedhën shqiptare.⁹⁴ Shqipëria i kërkonte Bashkimit Sovjetik që kursi i këmbimit me rublën e re të ishte jo më shumë se masa 1 rubël=55,55 lekë.⁹⁵ Nëse do të merrej për bazë kursi i ri, atëherë ndryshonte edhe kursi i këmbimit lek/dollar në masën 1 USD=112,50 lekë.⁹⁶

Spiro Bakalli dhe Iljaz Fishta në raportin e tyre i konsideruan bisedimet në Moskë si të ftohta dhe sjellje jokorrekte,⁹⁷ dhe madje sipas tyre drejtori i Bankës së Shtetit, Korovushkin, e kishte nënvlerësuar takimin me ta.⁹⁸ Duke parë qëndrimin sovjetik mbi çështjen në fjalë, i dërguari shqiptar kishte bërë propozimin që të paktën kursi i ri i këmbimit rubël/lek të ishte në masën 1 rubël (e re)=100 lekë.⁹⁹ Megjithatë, pala sovjetike nuk kishte lëshuar pe.¹⁰⁰

⁹³ *Po aty*.

⁹⁴ *Po aty*, fl. 31.

⁹⁵ *Po aty*. Pjesë nga letra: "Megjithëse neve u paraqitëm të gatshëm që përkohësisht të botohej kursi jo-tregtar midis lekut dhe rublës së re, Ju nuk ishit të një mendimi. Neve çdo botim të kursit zyrtar në buletinat tuaja, sipas tezës Tuaj, do ta quajmë si një akt të njëanshëm dhe jo të përshtatshëm për marrëdhëniet midis bankave të të dy vendeve socialiste. Në qoftë se kjo do të ngjasë, kundër dëshirës sonë, do të ruajmë të drejtën që në buletinet tona të kurseve zyrtare të shpallim kursin lek 55.55 për një rubël të re"; shih edhe *po aty*, fl. 54. Kursi zyrtar i këmbimit të lekut nga krijimi i tij në vitin 1947, sipas bisedimeve që u zhvilluan në Moskë nga Spiro Bakalli dhe Iljaz Fishta në vitin 1960 ishte: 1 USD=5.0 lek; 1 paund britanik=201.50 lekë; 100 franga zvicerane=1162.79 lekë; franga ari 100 (pesha gram 32.25806 pesha bruto)=1.630 lekë; me vendimin e 2 marsit 1950, 1 napolon ar (me përmbajtje ar bruto gram 6.4516)=326 lekë; 1 gram ar i thjeshtë=56.30 lekë; nga viti 1950, 1 rubël=12.50 lekë.

⁹⁶ *Po aty*, fl. 58.

⁹⁷ *Po aty*, fl. 60.

⁹⁸ *Po aty*, fl. 61.

⁹⁹ *Po aty*, fl. 65.

¹⁰⁰ *Po aty*; shih edhe: *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 24, fl. 1-8. "Relacion informativ mbi bisedimet që u zhvilluan për caktimin e kursit zyrtar dhe shpenzimet jo tregtare në mes lekut dhe rublës së re. Delegacioni: Spiro Bakalli, Iljaz Fishta".

Fakt është se, Shqipëria nga 1 janari 1961, do të paguante dhjetëfish më shumë kreditë dhe pagesat e tjera jotregtare që i detyrohej Bashkimit Sovjetik e vendeve të tjera të Kampit Socialist. Në frymën e letrave të lartpërmendura sovjetike, në Shqipëri "vërshuan" letra të tjera ku njoftohej ndryshimi i kursit të pagesave prej Bankës Shtetërore Çekosllovake (29 nëntor 1960),¹⁰¹ Bankës Kombëtare Hungareze (20 nëntor 1960),¹⁰² Bankës Kombëtare Polake (13 dhjetor 1960),¹⁰³ Bankës Popullore të Kinës (14 dhjetor 1960),¹⁰⁴ Bankës Kombëtare të RDGJ-së (26 nëntor 1960),¹⁰⁵ Bankës Shtetërore Sovjetike (22 dhjetor 1960),¹⁰⁶ Bankës Popullore të Rumanisë (3 janar 1961).¹⁰⁷ Duke parë qëndrimin e prerë sovjetik, Shqipëria më 23 dhjetor 1960, kishte marrë vendimin që kursi zyrtar i lekut në raport me rublën sovjetike të mos botohej në asnjë buletin.¹⁰⁸ Në ndjekje të politikës financiare sovjetike dhe ndryshe nga Shqipëria, të gjitha vendet e Kampit Socialist bënë ndryshimet përkatëse në kurset e këmbimit të monedhave të tyre.¹⁰⁹

Si politikë financiare, Bashkimi Sovjetik rivlerësimin e rublës e kishte nisur që në mbledhjen e Sovjetit Suprem (parlamentit), më 5 maj 1960.¹¹⁰ Sipas Vasil Duros, kryetar i degës së Marrëdhënieve me Jashtë të Bankës së Shtetit Shqiptar, forcimi i rublës ishte real si pasojë e paritetit rubël/ar (fino-1000/1000)=0.222168, ndërsa dollari amerikan krahasuar me arin kishte pësuar rënie përgjatë viteve 1914-1959 në vlerën 0.888 gr. fino dhe sipas tij nuk i përgjigjej realitetit.¹¹¹ Ky raport, në fakt, nuk i përgjigjej realitetit. Shtetet e Bashkuara të Amerikës në veçanti dhe Europa Perëndimore në përgjithësi, kishin hyrë në epokën e artë të zhvillimit ekonomik. Të gjitha manovrat që po bënte Bashkimi Sovjetik dhe pas tij vendet e Kampit Socialist, kishin si synim t'u afroheshin sadopak ekonomikisht vendeve të Perëndimit dhe ekonomive të tyre.

¹⁰¹ *Po aty*, fl. 33.

¹⁰² *Po aty*, fl. 37.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 76.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 81.

¹⁰⁵ *Po aty*, fl. 87-88.

¹⁰⁶ *Po aty*, fl. 93.

¹⁰⁷ *Po aty*, fl. 140.

¹⁰⁸ *Po aty*, fl. 103.

¹⁰⁹ *Po aty*, fl. 104-125.

¹¹⁰ *Po aty*, fl. 126.

¹¹¹ *Po aty*.

Shqipëria si vendi më i dobët ekonomikisht i Kampit Socialist, nuk kishte asnjë lloj mundësie për të ndikuar në politikat zyrtare të BS-së, aq më tepër kur ndryshimi i kursit të rublës prekte akoma më rëndë ekonominë zyrtare. Me gjithë përpjekjet e delegacionit shqiptar në Moskë Bakalli-Fishta, sipas njoftimit të tyre më 31 dhjetor 1960, zyrtarisht Bashkimi Sovjetik nuk pranonte botimin e kursit të këmbimit lek/rubël sipas propozimit të palës shqiptare dhe derisa të arrihej një marrëveshje, duheshin bërë studime duke marrë për bazë prodhimin global me çmimet shumicë/pakicë dhe kursi për veprimet jotregtare të ishte 1 rubël (e re)=100 lekë.¹¹²

Sipas palës shqiptare, kjo lëvizje e Moskës nënvlerësonte në mënyrë të njëanshme lekun shqiptar, por nuk guxoi të kundërshtonte dhe pranoi të botohej në buletinët zyrtarë kursi i lartpërmendur ndërmjet rublës (së re) dhe lekut.¹¹³ Po ashtu, Shqipëria u detyrua të ndryshonte kurset e këmbimit me të gjitha vendet socialiste dhe kapitaliste. Kështu, dollari amerikan i rritej vlera gati 100% (1 dollar=112,50 lekë nga 1 me 50 që pretendohet).¹¹⁴

Shqipëria përballë politikës së re financiare që do të aplikohet nga Moska gjendej edhe më shumë në vështirësi serioze. Ndryshimi me dhjetëfish i kursit të rublës ishte shkatërrimtar për ekonominë e vendit. Moska me anë të kësaj politike i merrte Shqipërisë përveç përqindjeve të larta të kredive, dy herë më shumë parë krahasuar edhe me faljen e një pjesë të tyre që kishte akorduar më parë (shih pjesën e parë të këtij studimi në “Studime historike”, nr. 1-2, 2022). Shqipëria tani kishte nevojë urgjente për pará kudo që të ishte e mundur.¹¹⁵ Sado të mbledhte edhe prej shtetasve shqiptarë të vdekur në Itali e gjetkë dhe që pasuritë e tyre modeste nuk i kishte trashëguar kush,¹¹⁶ përsëri Shqipëria e kishte të pamundur të mbushte arkën e vet. Banka e Shtetit Shqiptar ishte hedhur në sulm të plotë për të gjetur pará kudo nëpër Europë, që mund të ishin investuar si kapital aksionar nga ish-Banka Kombëtare e Shqipërisë para

¹¹² *Po aty*, fl. 130. Mbi caktimin e kursit midis lekut dhe rublës.

¹¹³ *Po aty*, fl. 131.

¹¹⁴ *Po aty*, fl. 135.

¹¹⁵ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 40, fl. 23. Mbi pasuritë e shtetasve shqiptarë në Itali.

¹¹⁶ *Po aty*.

dhe gjatë luftës.¹¹⁷ Jo vetëm këto, por brenda vendit gjatë vitit 1960, kishite filluar një gjueti e re shtrigash për konfiskime të mjeteve me vlerë nga Sigurimi i Shtetit qytetarëve shqiptarë.¹¹⁸ Shteti po u shkulte qytetarëve të tij çdo gjë me vlerë që kishin mundur ta shpëtonin deri në atë moment, deri edhe unazat e çmuara që ndokush pa kujdes mund t'i mbante në gisht.¹¹⁹

Politikat e gabuara financiare të udhëheqjes komuniste shqiptare dhe jo vetëm ato, por edhe papjekuria politike e Enver Hoxhës pas 15 viteve pushtet absolut, e kishin çuar Shqipërinë buzë humnerës. Në një tjetër dokument të rëndësishëm, pranohej se në Shqipëri bëheshin ndërtime më të mëdha se nevojat, madje edhe me teprime, duke sjellë si shembull ndërtimin e Kombinatit të Naftës afër Fierit.¹²⁰ Madje, teprimet ishin të tilla sa që instaloheshin nëpër godina instalime hidrosanitare pa ndërtuar më parë ujësjellësin.¹²¹ Këto gjëra e shumë para të tjera që shkonin dëm, përpiqeshin të justifikoheshin si investime në kundërshtim me urdhrat e qeverisë.¹²²

Përfundime

Është e vështirë që pas një artikulli studimor me përmbajtje të tillë të mund të mos ketë debate lidhur me mbijetesën politike të Enver Hoxhës. Shpresoj se ky artikull studimor të jetë një risi për shkencën historike shqiptare. Debatet me kolegë të nderuar pas prezantimit të tij, nuk kanë munguar. Mendoj se kam arritur t'i bind me aq sa kam mundur sipas fakteve të paraqitura, se arsyeja e vërtetë e mbijetesës ekonomike dhe rrjedhimisht politike e regjimit komunist në Shqipëri dhe personalisht e Enver Hoxhës, ishin manovrat ekonomike për të përfituar nga "bamirësi" i momentit. Artikujt e mi të mëparshëm lidhur me fundin

¹¹⁷ *Po aty*, fl. 26. "Detyrimi i ish Bankës Kombëtare të Shqipërisë pranë Banque de Reglements Internationaux. Shqipëria bëhet pronare e 500 aksioneve me vlerë monetare Fr.ari 1 250 000".

¹¹⁸ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 78, fl. 2, 7, 9, 11, 15, 16-17, 29, 31, 32, 34, 36, 38...95. Sekuestrime dhe dorëzime në Bankën e Shtetit Shqiptar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

¹¹⁹ *Po aty*.

¹²⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 98. Relacion mbi leverdishmërinë ekonomike të ndërtimeve kapitale.

¹²¹ *Po aty*, fl. 2.

¹²² *Po aty*, fl. 5.

e viteve 50-të dhe fillimin e viteve 60-të (veçanërisht harku kohor 1958-1962¹²³), tregojnë qartësisht mënyrën se si lëvizte diktatori shqiptar dhe klika e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare të cilat ishin vetëm me një kahje, Kampin Socialist deri në vitin 1960 dhe Republikën Popullore të Kinës nga viti 1961 deri më 1978.¹²⁴ Pas qëndrimit të Hoxhës në mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore, Bashkimi Sovjetik "me mirësjellje" kërkonte nga Shqipëria që t'i paguhej çdo qindarkë sipas kursit të ri të rublës. Dhe Shqipëria, duke filluar nga fundi i muajit qershor pas mbledhjes së Bukureshtit e sidomos pas nëntorit të vitit 1960 e në vitet në vijim, i ka paguar Moskës të gjitha ato çfarë kjo e fundit i kishte akorduar financiarisht duke zbatuar me përpikëri të gjitha kontratat.¹²⁵ Personalisht, mendoj se arsyeja e parë e mbijetesës politike e Enver Hoxhës pas prishjes së marrëdhënieve me Moskën, ishte shlyerja e kredive që i kishte marrë Bashkimit Sovjetik. Deri më 29 korrik 1960, Shqipëria sipas Bankës kishte shlyer apo ishte duke shlyer borxhet në llogari kleringu dhe llogari krediti në rubla vendeve socialiste si më poshtë vijon:

	Shtetet	Klering	Kredi
1	B.R.S.S.	42 005 226,24	295 515 209,89
2	Çekosllovakisë	3 557 509,40	112 353 945,65
3	Bullgarisë	12 879 990,30	45 325 253,87
4	Rumanisë	343 180,10	89 418 781,91
5	Hungarisë	2 413 778,60	74 282 661,15
6	Polonisë	6 705 023,80	74 135 131,61
7	RDGJ-së	13 057 421,30	35 364 606,92
8	Kinës	461 176,86	75 089 484,14
9	Jugosllavisë	327 471,40	
10	Gjithsej (rubla)	81 750 778,70 (klering)	801 485 075,14 (kredi). ¹²⁶

¹²³ Gjon Boriçi, "Varësia e mbijetesës ekonomike të Shqipërisë nga ndihmat dhe kreditë e kampit socialist dhe të Republikës Popullore të Kinës 1956-1962", në *Studime historike*, 1-2 (2020), 213-234.

¹²⁴ Gjon Boriçi, *Marrëdhëniet shqiptaro-kineze në Luftën e Ftohtë 1956-1978*, bot. II, (Tiranë: GEER, 2022).

¹²⁵ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 46, fl.1-747. Skeda të likuidimeve financiare të Bashkimit Sovjetik pas mbledhjeve të qershorit në Bukuresht dhe nëntorit në Moskë.

¹²⁶ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1960, D. 29, fl. 2. Llogari kleringu e krediti Kinës dhe vendeve të Kampit Socialist.

Deri më 31 dhjetor 1960, detyrimet e shtetit shqiptar po sipas këtij raporti të Bankës, karshi Bashkimit Sovjetik dhe Demokracive Popullore ishin:

Detyrimet e shtetit shqiptar ndaj:

	Shtetet	Rubla
1	B.R.S.S	340 914 359,30
2	Çekosllovakisë	122 301 703,46
3	Bullgarisë	46 369 117,70
4	Rumanisë	92 809 497
5	Hungarisë	76 399 177,56
6	Polonisë	75 251 219,53
7	RDGJ-së	35 632 822,86
8	Kinës	97, 923 738,73
9	Gjithsej	887 601 637,05¹²⁷

Nga hulumtimi i kujdesshëm i dokumenteve arkivore të viteve pasuese, shlyerjet janë bërë duke respektuar kontratat e nënshkuara edhe gjatë viteve 60-70-të dhe gjysmën e parë të viteve 80-të. Është e qartë se diktatori shqiptar nuk mund t'i bënte as devijimin më të vogël politiko-ekonomik Moskës, pa i kthyer kreditë që kishte marrë. E dinte mirë se çdo të thoshte ta kundërshtojë, aq më tepër ekonomisht. Eksperiencat e kundërshtimit ndaj Moskës e Gjermanisë Lindore më 1953, e Polonisë më 1955 dhe mbi të gjitha e Hungarisë më 1956, ishin shumë domethënëse. Bashkimi Sovjetik nuk kishte "mëshiruar" asnjë deviacion politik ndaj këtyre vendeve, pasi edhe këto kishin marrë kredi nga ai. Hulumtimi i kujdesshëm i literaturës ndërkombëtare na jep të dhëna impresionuese mbi borxhet që vendet e kampit kishin ndaj vendit lider të komunizmit dhe mënyrës se si përdroreshin ato.¹²⁸

Nga një raport i datës 21 janar 1976, drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë të Bankës së Shtetit Shqiptar, Perikli Samsuri, i dërgoi një raport të hollësishëm Ministrisë së Financave të RPSH-së prej

¹²⁷ *Po aty*, fl. 8. Vendeve të lartpërmendura borxhe sipas marrëveshjeve në klering, Shqipëria u detyrohej deri më 31 dhjetor 1960, 48 144 779,36 rubla.

¹²⁸ Shih: Ian Jeffries, *Socialist economies and the transition to the Market; a guide* (London and New York: Routledge, 1993); David Dyker, *The Soviet Economy* (London: Crosby Lockwood, 1976); Ian Kershaw, *The global age; Europe 1950-2017* (United Kingdom: Viking, 2018); Paul Thomas Chamberlain, *The Cold War killing fields; rethinking the long peace* (New York: Harper Collins Publishers, 2018); etj.

tri pikash ku më e rëndësishmja ishte pika tre e cila bënte fjalë për gjendjen, përdorimin dhe shlyerjen e kredive për vitin 1975 dhe në total sipas shteteve e marrëveshjeve të veçanta.¹²⁹

Sipas pasqyrës së evidencës, specifika e shlyerjeve të kredive ndaj Bashkimit Sovjetik ishte më e veçantë. Më 12 dhjetor 1975, Banka për Tregtinë e Jashtme të BS-së i dërgoi një evidencë drejtorisë qendrore të Bankës së Shtetit Shqiptar, ku i kërkonte të shlyhej me urgjencë nga data 12 dhjetor deri më 29 dhjetor 1975 shuma prej 1 249 507,02 rubla në favor të llogarisë sovjetike, gjë që u krye nga BSHSH-ja.¹³⁰ Po ashtu, brenda muajit dhjetor 1975, Shqipëria kishte për të shlyer edhe 125 804 120 rubla sipas evidencës së dërguar nga Banka për Tregti të Jashtme e BS-së, të cilat i kishte depozituar në numrin e saj të llogarisë në filialin e kësaj banke në Moskë.¹³¹

Sipas literaturës ndërkombëtare që kam shfrytëzuar për këtë studim, më rezultoi se deri në vitin 1989, borxhi i Shqipërisë ndaj BS-së ishte 127.8 milionë rubla.¹³² Deri më tani nuk kam arritur ta konfirmoj këtë shumë nga hulumtimet në arkivat shqiptarë.

E gjithë historia e Luftës së Ftohtë për Shqipërinë tregoi se shteti komunist shqiptar bëri një keqmenaxhim të ekonomisë dhe kishte një mungesë totale të standardit më minimal të çdo përllogaritjeje të logjikshme, e cila në thelb ka bashkëpunimin. Shteti shqiptar në radhë të parë ishte zhatës i vetë popullit të tij dhe e kishte totalisht të pamundur të kuptonte mësimin e madh të një ekonomie të pranueshme, e cila sipas standardeve më të larta makroekonomike ka në qendër tre P: personin, pronën, premtimin.¹³³ Tek të tre këta elementë shteti komunist shqiptar dështoi me dëshirë për t'ua lënë trashëgim brezave një prej tragjediave më të mëdha ekonomike në të gjithë historinë e Shqipërisë.

¹²⁹ *AQSH*, F. 506/BSHSH, V. 1975, D. 25, fl. 1. Mbi evidencën e të ardhurave dhe shpenzimeve në devizë të lirë për vitin 1975; mbi evidencën dhe shlyerjen e kredive për vitin 1975; evidencën e të ardhurave dhe të shpenzimeve në devizë të lirë për vitin 1975.

¹³⁰ *Po aty*, F. 506/BSHSH, V. 1975, D. 37, fl. 64. Evidenca të shlyerjeve të kredive nga Shqipëria në favor të Bashkimit Sovjetik.

¹³¹ *Po aty*, fl. 65.

¹³² I. Jeffries, *Socialist economies...*, 233. Autori Jeffries këtë shifër e ka cituar nga CDSP (Current Digest of the Soviet Press), 1990, vol. XLII, no. 9, p. 9, (since 5 February 1992 Post-Soviet).

¹³³ J. R. Otteson, *Seven deadly economic ...*, 31.

...continues from the previous issue

GJON BORIÇI

Institute of History/ Academy of Albanological Studies, Tirana
gjon.borici@asa.edu.al

S u m m a r y

THE SOVIET CREDITS AND LOANS GRANTED TO ALBANIA
IN THE PERIOD 1945-1960 (PART TWO)

The problem of liquidating Albania's credits and loans toward the Soviet Union were a permanent concern for the Albanian communist government during all the period of the Cold War. It was impossible for such a small country as Albania to pay all those debts without being supported from another big power. China saved Enver Hoxha's power in assisting him in the difficult year 1960 and the following years in granting to Albania huge amounts of credits for the communist regime survival in the Balkan' Europe. The Soviet Union was a heavy burden on Albania's shoulders. The economic pressure Albania found herself in the late '50ies and especially in the period 1960-1961 sounds unreal for the period taken into consideration. The enormous loans that the Soviet Union granted to Albania were liquidated thanks the Chinese assistance until the second half of the seventies. As its revealed in this paper, the communist regime survived because Albania nevertheless the weak financial position and nevertheless the poorest country in Europe, succeeded to pay back Moscow's loans granted to her. Never before in the Albanian historic science and abroad has been made such an analyze to understand why Enver Hoxha survived the political clash with Moscow in Bucharest first and above all in Moscow's Kremlin. It is understandable that ideology is only a fake shadow to disguise the true nature of the political relations between countries. As has been demonstrated in this paper, economy is the answer of all political problems between the nations.

